



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimi/Pranimja Më 19-02-2026			
Nr. Llogarit Gj. Broj	Nr. Llogarit Gj. Broj	Nr. Llogarit Gj. Broj	Vlera Vrednost
01	060	101	231



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **III** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **27.02.2026, (e premte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2025
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2026.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e anëtarëve të kuvendit komunal të Vitisë të cilët do të përfaqësojnë komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete projekt i realizuar ne vitin 2025 dhe 20% e participimit të fermerve përfitues ne mekanizem bujqesor dhe serra nga subvencionet per vitin 2026.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me nr. 1088-2 me sipërfaqe 17758 m² në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla" e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e Qerdhes dhe parcela në të cilën do të ndërtohet Qerdhja do të jete parcela nr 1088-2 me sipërfaqe 4000 m².

Viti, më 19.02.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË DYTË TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesuesi i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 30.01.2026 (e premte), në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i komunës z.Hasan Aliu, drejtorët komunalë, zyra e OSBE-së, mediat elektronike, këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, z.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Sokol Shaqiri, z.Bekim Rama, z.Faruk Shabani, znj.Yllka Qamili, znj.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Nuhi Ramadani, z.Visar Demiri, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, znj.Mirjeta Hamiti, znj.Liridona Bislmi, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, z.Labinot Bislmi, z.Elham Emërllahu, ndërsa mungoi z.Jakup Demiri.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë. Kjo është seanca e dytë e Kuvendit Komunal të këtij mandati. Materiali e keni marrë me kohë për këtë seancë dhe, pak para se me fillu këtë pjesë, po ju njoftoj se, nga mbledhja e fundit u kthye vendimi për zgjedhjen e kryesuesit konform dispozitave ligjore, ndërsa vendimi tjetër ende nuk është kthyer. E dini se çdo vendim apo rregullore që miratojmë e dërgojmë në ministri për konfirmim të ligjshmërisë; brenda 7 ditëve jemi të obliguar me i dërgu në ministri, ndërsa ministritë e linjës e konfirmojnë ligjshmërinë e akteve të miratuara në kuvend. Çdo akt që s'është në përputhje me ligjin kthehet në Kuvend të plotësohet ose shfuqizohet. Pasi që ka këshilltarë të rinj në këtë përbërje, kryesuesi i njoftoi rreth punës së Kuvendit Komunal. Materialin e keni marrë me kohë. Me propozimin që e kemi bërë te rendi i ditës, pika me nr. 7 e rendit të ditës tërhiqet nga rendi i ditës, për arsye se duhet me ardh lista e pronave që jepen në shfrytëzim; duhet të miratohet këtë vit. U vonua kjo listë, sepse kemi qenë në zgjedhje. D.m.th. pika 7 e rendit të ditës tërhiqet nga rendi i ditës. Në kuadër të propozimeve të rendit të ditës, e kam edhe një material që na ka ardhur për pikë shtesë të rendit të ditës. Është pikë urgjente për arsye të dëmeve që janë shkaktuar nga vërshimet dhe qeveria e ka kërkuar që të miratohet lista e dëmeve. Komisioni e ka përfunduar raportin gjatë kësaj jave dhe, para se me thirr seancën, nuk ka qenë gati raporti. Tash e kanë sjellë, dhe raporti është i gatshëm. Në kuadër të raportit që e kam për dëmet materiale, kërkoj që propozimit të rendit të ditës t'i bashkohet propozim vendimi për miratimin e raportit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore të vërshimeve në Komunën e Vitisë dhe raporti i vlerësimit për dëmet e shkaktuara në bujqësi. Kjo është një pikë e rendit të ditës. Hapi diskutim.

z.Basri Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ne, duke pasur parasysh se edhe në legjislaturat e kaluara pika e parë e rendit të ditës ka qenë pyetje dhe përgjigje jashtë rendit të ditës, mendoj që këtë ta shtim si pikë të rendit të ditës që të jetë në fund, për arsye se edhe ekzekutivi nuk po qëndron deri në fund që me qenë prezent këtu dhe po na merr kohën në kuptimin tjetër që e kemi për me diskutu pikat më të rëndësishme që janë. Pra, unë e kam këtë propozim.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë deshta mu ndërlidh me diskutimin e parafolësist që bënë një propozim të tillë, që pika e rendit të ditës “të ndryshme”, e cila është në fillim, të hidhet në fund të rendit të ditës, që kjo mos të diskutohet fare dhe të vazhdojë nga e kaluara ashtu siç ka qenë. Ju e dini se kemi

pasur diskutime edhe më herët për këtë. Unë mendoj që kjo duhet me qenë pikë në fillim, mendoj për shumë arsye, sepse shumica e drejtorëve po largohen dhe nuk na u përgjigjen fare në pyetjet që ne i bëjmë, dhe interesin e qytetarëve që e përfaqësojmë. Andaj, ne si grup i LVV-së jemi që kjo të mbetet e pandryshuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Zakonisht, kur e kemi informatën e kryetarit, kjo pikë është e lidhur me informatën e kryetarit. Për këtë arsye, në fillim nuk e hapa për diskutim a ka te rendi i ditës për diskutim.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Te pika që e kemi shtesë që u propozua, vazhdimisht jemi tu pas vërshime, si rruga Pozharan-Viti dhe bujqësia. E dini si është. Besoj që duhet me lanë si proces të hapur, se ka edhe njerëz që hala e kanë tokën në ujë dhe nuk e dinë sa dëme u ka shkaktuar, kështu që me lanë si proces të hapur.

z.Visar Demiri: Pajtohem me kërkesën e Basrisë për ndryshimin tek pyetje dhe përgjigje, me i qit në fund të rendit të ditës, sepse ne jemi të thirrur për pjesën përmbajtësore, zakonisht e kalojmë shumë shpejt e pa diskutime fare, për edhe ato arsye që i tha Basria.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Të jesh këshilltar komunal është punë shumë e madhe, e ndershme e respektume, por të jesh këshilltar komunal ke edhe shumë përgjegjësi të mëdha. Ju këshilltarët komunalë që jeni për herë të pare, duhet ta dini se qytetarët e komunës sonë faktikisht ju kanë punësuar që të punoni për të mirën e tyre. D.m.th. sot të jesh këshilltar komunal duhet ta llogaritni veten që jeni të punësuar. Ju duhet të punoni për interesat e qytetarëve e jo për interesa personale, pse ka këshilltarë komunalë edhe këtu edhe në mandatin tjetër që, hala pa fillu kuvendi mirë, tentojnë me përfitu për veti e harrojnë që kanë kërku vota prej qytetarëve. Ju këshilltarët komunalë e keni obligim që mos me i rrejt qytetarët, e kryetari bashkë me vartësit e tij duhet mos me i rrejt dhe mos me i vjedh, qysh kanë vjedh përherë. Bekim Azizi, urime zgjedhja e kryesuesit të kuvendit. Dashtë Zoti që të kalon mirë si kryesues i kuvendit, por mënyra qysh je zgjedh nuk besoj që ke me pas suksese deri në fund. Sa i përket pikës që tha Basria, shumë mirë e kishte kurdis, dhe unë propozoj që gjithmonë me qenë pika e parë e rendit të ditës, pyetje dhe përgjigje, se kjo pikë është pika më kryesore, sepse ato janë pyetje që ne i marrim nga qytetarët që na i japin neve, qytetarëve, me i thënë këtu, se na jemi të zgjedhur prej qytetarëve.

R e n d i t e

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal;
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal.
2. Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës së Vitisë për periudhën janar-dhjetor 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete.
5. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e iniciativës së kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës.
8. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunës së Saint Julien en Genevois;
b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunës së Saint Julien en Genevois.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. a) **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal**
b) **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për procesverbalin?

z.Remzi Salihu: Te mbledhja e parë e Kuvendit Komunal, grupi jonë i LVV-së e kemi lëshu mbledhjen, për arsyen që edhe ju e dini, andaj kërkoj që të plotësohet ky procesverbal, dhe në procesverbal të thuhet se, LVV-ja e ka lëshuar mbledhjen për arsye se nga kryesuesi i seancës ka braktisur mbledhjen me arsyen se nuk ju ka dhënë fjala për diskutim rreth futjes së pikës së rendit të ditës për krijimin e dy drejtorive plus. Në një komunë cila do qoft nuk mund të bëhet pa ndryshim plotësim të statutit të komunës, andaj kjo ka qenë.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Te procesverbalet a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal: a jeni që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Nga të gjithë u miratu kjo pikë. Tek pika b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal, me vërejtjet e Remzisë, edhe kjo pikë e rendit të ditës miratohet.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës së Vitisë për periudhën janar-dhjetor 2025

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës së Vitisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Pasi që paraqitja e parë e imja para jush, me lejoni që të gjithë këshilltarëve pa dallime të ju uroj mandatin e marrë dhe të ju uroj shëndet e suksese në punë. Kryetari i komunës, bazuar në Ligji për Vetëqeverisje Lokale është obligativ dy herë në 15-ditëshin e fundit të muajit të gjashtë, dhe 15-ditëshin e fundit të muajit 12, debat me qytetarë, po është obligativ, që edhe dy herë të sjell informat në kuvendin komunal për punën të cilën e ka kry në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe në përputhje me përgjegjësitë, kryetari tu e llogaritë veten të përgjegjshëm si çdo herë, sot para juve ka sjellë informatën të cilën e keni një pasqyrë bukur të mir për punën të cilën e kanë kryer ekzekutivi brenda vitit 2025, dhe sfidat të cilat janë ballafaqu brenda kësaj periudhe. Unë për shkak se do të ju lë hapësirë juve, nuk do të ju lodh. Për pyetjet shtesë jemi në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Basri Aliu: Duke i parapa të gjitha ato vështirësi të cilat kanë qenë, të cilat u thanë edhe nga nënkryetari, gjatë vitit të kaluar prap se prap u bë një punë e mirë nga ekzekutivi. Kanë mbet ende disa sigurisht pa u përfunduar, po edhe ato do t'i përfundojmë. Kjo është një informatë e kompletme.

z.Visar Demiri: Informata është për punët e kryme gjatë vitit 2025. Nuk kam diçka të veçantë. Në emër të grupit dhe ashtu asamblastët janë të ri, tani në këtë seancë uroj që vitit 2026 të jet vit me efektiv për punët e kryera në Komunën e Vitisë.

znj.Majlinda Shabani: Tek informata paraprakisht nënkryetari tha se janë disa obligime ligjore, të cilat zakonisht komunat duhet me iu përmbajt atyre obligimeve ligjore. Na e dimë që informata e punës për gjashtëmujorin e parë nuk ka ardhë në Kuvend. Komuna edhe kemi diskutu aty, ka qenë një shkelje që nuk ka ardhë ajo informatë e punës gjashtëmujore që ka qenë obligim ligjor, dhe këtu u bë shkelja e parë. E dyta, e cek një takim që është mbajtur kryetari me datë 22 dhjetor. Me sa e pashë edhe e lexova tash, tha që ka qenë takim me qytetarë, e unë aty vetëm takim me qytetarë nuk kam pa. Zakonisht kanë qenë drejtorë dhe njerëz që punojnë nëpër komuna, në administratë, dhe ka prezantuar punët e veta. E sa i përket këtij raporti, u bë një farë lloj praktike, thuajse komuna po e servon në Kuvend Komunal edhe na me diskutu. Ajo që na intereson më së shumti janë investimet kapitale, e nëse him me pa dokumentin që e kemi na tash këtu, aty nuk e kemi asnjë projekt që është cek që ka përfunduar, është nis apo në cilin proces është. Edhe këtu është ajo çështja e parë, që madje lidhet edhe me aspektin e transparencës dhe llogaridhënies. Sa i përket raportit apo informatës së punës që e kemi pas për këtë vit, zakonisht më shumë janë cek inicimet, dokumentacionet, zakonisht kemi për shqyrtim, që në fakt qytetarëve fare nuk iu hyn në punë. Në anën tjetër shohim projekte të cilat qytetarët duhet me qenë në dijeni edhe me qenë të informuar. Ajo çka është më interesante dhe më e çuditshme që po diskutohet sot, është se sa e ka dëmtu buxhetin e komunës së Vitisë kontrata kolektive, që e kemi diskutu edhe më herët, dhe në anën tjetër, pikërisht sot në Kuvendin Komunal, në seancën paraprake, e kemi një komunë e cila ka propozu dy drejtori të reja. D.m.th., tu e marrë parasysh gjendjen se qysh e kemi ne aspektin financiar të komunës së Vitisë,

e pasmi luksin dhe pasmi hapësirë financiare për me i shtu edhe dy drejtori të reja, shtrohet pyetja se ku kanë me i marrë mjetet financiare për shtimin e këtyre dy drejtorive të reja. Ki zvogëlim të mjeteve financiare në investime kapitale për shkak të arsyetimit thuajse që jam tu e dhënë, dhe në anën tjetër shtimi i dy drejtorive të reja ka rezultu që kanë me shku me u zvoglu prapë mjetet financiare te investimet kapitale. Shtrohet pyetja këtu: ku po zhvillohet qyteti dhe ku po zhvillohet vendi? Çka po du me ndërlidh te investimet kapitale, sepse mendoj që është shumë e rëndësishme. Ka fillu një mandat i ri, është një avaz i vjetër. Kemi pa, e kemi miratu një buxhet për vitin 2026, që në fakt e dimë edhe formën se qysh ka ardhë ai buxhet. E kemi pak a shumë projekte që janë, po një diçka që jam tu e pa problem: projektet që kanë qenë të përfunduara në vitin paraprak duhet mu kap ato projekte me rifillu prej fillimit. E ki rrugën rreth lumit Morava, po e përmendni këtë që mos me hi në investime tjera që duhet urgjentisht me intervenu në atë rrugë. Ajo ka qenë gjatë vitit 2025 investim kapital për vitin, i cili investim e ka vështirësu jetën e qytetarëve. Nuk mundesh kurrqysh me u qas në atë rrugë dhe tash shtrohet pyetja se çka ki me ba tash e tutje. Në këtë informatë, çka është më e çuditshme, nuk janë përmend vështirësitë edhe pengesat që i ka pas. Kemi pas orë të humbura në arsim, nxënësit, konkurset e punësimet të cilat janë vonu, dhe këtu në informatë nuk i keni cek as këto, ose vështirësitë që i keni, ose ato çka keni bë. Një diçka që po du me cek dhe po du me shtru edhe pyetje: e kemi pas ditëve të fundit edhe një rast ku punëtorët teknikë të pastrimit e kanë pas një protestë paqësore, një protestë kështu formale që e kanë bë për shkak të pagave që kanë mbet pa paga. Pasi e kemi kryetarin këtu, po du me ia bë pyetje se cila ka qenë arsyeja që janë vonu pagat dhe çka ka me ndodhë me ata. Po përpos kësaj, sa kam informata, po du me u informu edhe rreth kontratave që i keni bë me Kosova Med dhe Karitasin, ku keni punësu qindra qytetarë në kohë fushate me kontrata tre mujore, gjashtë mujore, dhe janë disa të punësuar aty që kanë katër-pesë muaj që nuk kanë marrë pagë. A mundesh me na tregu arsyen pse nuk kanë marrë pagë? Dhe tjetra, çka po du me u ndërlidh te informata e punës, është pikërisht kjo: investimet kapitale. Nuk kemi çka me diskutu sot, është për me na fye inteligjencën që keni pru një informatë të punës, po sa informatë e punës, më shumë aspektet e proceseve. Kurgja tjetër nuk ka me pa punën që e keni bë ju, ama puna shihet në terren, problemet që i kanë qytetarët, dhe i kemi diskutu edhe më herët. Për mu, kjo s'është një raport i punës.

z.Ekrem Abazi: Unë po e bëj një pyetje: çka keni bë qe katër vite për ujin e pijshem për qytetarët e Komunës së Vitisë, e në veçanti në vitin 2025. Konkurset që i keni hap në shumë shkolla për shumë mësimdhënësia e keni ndalu një herë. Fëmijët tonë kanë mbet, nuk ka fillu viti shkollor për shumë fëmijë tonë, nuk ka fillu në shtator, po ka fillu në dhjetor. Pse ka ndodhë kjo? Keni marrë njerëz me kontratë mbi vepër në muajin shkurt kur ju kanë vyt për vota. Në muajin tetor e keni shtu hala, i keni hek kur kanë përfundu zgjedhjet. Në muajin tetor prapë keni marrë shumë bile, nuk ka pas në shumë vende ku mu ulë në komunë, sidomos tek ambullanta edhe nëpër komunë keni marrë punëtorë pa numër, as vet nuk e dini sa i keni marrë, në fund kanë met pa paga ata njerëz.

z.Remzi Salihu: Të nderuar kolegë, përderisa po flasim për informatën e punës së kryetarit për periudhën janar-dhjetor 2025, unë do kisha thanë që kjo është një informatë e mangët dhe e congume, edhe pse voluminoze, megjithatë nuk do të kisha thanë se asgjë nuk është punuar, por këtu shumë gjëra në mënyrë dëshirore fliten se janë punuar, do të punohen etj, dhe janë kryer të gjitha punën në bazë të parapara sipas programit dhe në bazë ligjit, që kjo sipas meje le për të dëshiruar shumë. P.sh.: unë po ndalem te aspekti i ujësjellësit dhe kanalizimit, pasi që kolegeja ime e tha në përgjithësi, e ku thuhet në Komunën e Vitisë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit përgjegjës është kompania regjionale "Hidro Morava", Njësia në Viti. E lexova këtë, se e di që ma thuani në replikë se kush është, po megjithatë në këtë kujdesje nuk hynë disa fshatra, e në mesin e tyre është fshati Remnik, i cili nuk ka fare sistem të ujësjellësit, e ka rrjetin e lëshuar që nga viti, po thamë para 12-13 vite, mos më merrni për fjalë, e rrjeti është i lëshuar, ndërsa asnjë iniciativë nuk është bë që për qytetarët e fshatit Remnik të rrjedh uji. Është edhe kanalizimi. Unë si përfaqësues i qytetarëve, dhe nga radha e LVV-së, 1 muaj, 4-5 here ose edhe më tepër e kam paraqit problemin e kanalizimit tek lagjia "Sejdia", që kjo i ka sigurisht dy vite kur është paraqit ky problem, dhe aty nuk është ndërmarr fare asnjë veprim për përmirësim të kësaj infrastrukture. Nuk e di unë si duhet të merrem vesh ne, kur thuhet që këto kërkesa paraqiten edhe në drejtori, e në drejtori janë paraqitur, edhe se paku se di sa here edhe mandje janë

adresuar edhe tek Zyra e Kryetarit, e asgjë nuk është bë fare si është e mundshme, që një pjesë shumë e vogël të sanohet dëmi në këtë kanalizim. Nuk mund të bëhet e të bëhet një pjesë e kanalizimit të ri me një pjesë tjetër. Më vjen mirë që është bë ajo, edhe unë do të isha të behet ajo, po si shkojnë këto politika të përgjegjësve komunal në këtë mënyrë, mandje tek arsimi do të isha ndërlidh. Në informatë situata paraqitet e knaqshme, por realiteti është ndryshe, konkurset, anulimi i konkurseve, mungea e mësimdhënësve, orët e humbura, notimi pa mbulesë i nxënësve, pastaj ndërtimi i nxemjes që ka shkaktuar humbje të orëve të mësimi. Pse nuk janë cekur këto në informatë? Mandje për nxemje është bë një intervenim atë hokë, i cili në mënyrë pak a shumë i ka përmbush kushtet, po jo kushtet normale që duhet të jenë për mësimin cilësor, prandaj edhe këtu do të bëja pyetje, se me çfarë procedure janë marrë këto nxemje që janë vendos nëpër klasat e shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës”: me çfarë çmimi dhe me çfarë kontrate? Dhe në fund pyes kush është përgjegjësia, apo a do të përgjigjet kush për orë të humbura të mësimi, qoftë nga konkurset e anuluar apo nga amienti i krijuar për mësim.

znj.Majlinda Shabani: Tek mirëmbajtja dimërore verore e rrugëve lokale, unë kisha dashtë prej drjetorit, sepse po e shofim që periudhën e dimrit kemi raste kur bjen borë ditëve të vikendit, i cili e thirrë personin përgjegjës në komunë, thotë valla ditë e diell ka qëllu, e tash borë ka ra, rrugët janë të bllokume, çka me ba tash, është mirë ndoshta si komunë me marr me ba publike planet e reagimeve, si bëhen në situata të tilla që edhe qytetarët me qenë të informuar, po edhe diçka që po du me cek, ai raporton qaj kontraktori që e keni, operatori ekonomik për qeto mirëmbajtjet e rrugëve dimërore, zakonisht kur të bjen borë. Ajo çka shifet, rrugët janë me ngrica komplet dhe nuk kam pa që kompania qe e keni kontraktu ju që paguhet prej komunës, tu e kry punën e vet siç duhet.

z.Lulzim Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Tek lagjeja “Dëshmorët e Kombit” në Viti, ku kanalizimi dhe sa herë që ka reshje del mbi rrugë aty ka probleme shumë të mëdhaja aty kur të kalojnë nxënësit e automjetet është tepër keq edhe prej kundërmimit të erërave të kanalizimit. Aty është rrezik sa herë kalojmë me vetura, se mundet me u fut uji në veturë, ma ajo veturë nuk duhet. Është gjendje urgjente aty, edhe është problemi i ndriçimit publik në atë lagje prej para viti të ri, nuk kemi edhe vitin 2025 nuk ka pas ndriçim tek parku i komunës se re, dhe tek shtatorja “Bafti Haxhiu”, diku rreth gjashtë muaj ditë derisa kam bë kërkesë në drejtorinë këtu në Viti disa here edhe problemi dhe kërkesa e qytetarëve të fshatit Kabash është ujësjellësi mbi shkollë përpjet nuk ka ujësjellës aty hiq. Ju është premtu edhe disa pompa me e qu ujin, mirëpo nuk është bë. Flitet se do të qitet një tender për me shtu kapacitetin e ujit aty, mirëpo nuk është bë ende asgjë. Procka që vjen nga Kabashi në Viti, kjo tek komuna e re deri në kthesën e parë tek rruga “Hasan Kabashi” është lënë anash. Aty ka rrezik që çdo vit ka vetura që binë në prockë. Është mirë me intervenu aty te ajo prrockë. Edhe trotuari është i ngushtë aty për këmbësorë.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, informata që kemi sjell është ligjore dhe e kemi obligim ligjor. Është performancë edhe pse tash jemi përbërje e re dhe kemi bërë planifikim të ri katërvjeçar, po edhe pse janë mbajtur debate me qytetarë, seanca dëgjimore me rregull, dhe pse dikush e ka votuar e dikush s’e ka votuar buxhetin, e po flitet më shumë për buxhet pa e votuar fare. Është mirë qytetarët me ditë saktë se kush po interesohet për interesin e tyre, e nëse ka mundësi pa buxhet mu mirëmbajt rrugët, pa buxhet mu ndreq kanalizimi, pa buxhet mu riparu shkollat, e nxënësit pa seanca dëgjimore për buxhet ku pjesëmarrja aktive e drejtpërdrejt e qytetarëve. Por mos harroni diçka, jo me fajin e kryesuesit, po sa për rikujtim: jemi tu fol për informatën 2025, keni me pas edhe informatën 2026. Po nuk duhet me harru që për shkak të punëve të mira të vitit 2025 dikush i ka fitu zgjedhjet dhe ka implementu strategji katërvjeçare edhe planifikim të buxhetit, dhe pikë për pikë premtimet që i kemi dhënë i kemi në program, dhe interesi i qytetarëve është prioritet. E bëjmë publike edhe strategjinë, kemi me çu Vitinë përpara në të gjitha aspektet. Po duhet të ceket se nga kontrata kolektive komunës së Vitisë ju kanë marrë mbi 8 milionë, llogaritni me proporcion me komunitat e mëdha, edhe në anën tjetër i humbin edhe grantet e performancës sepse kualifikohemi për kontratë kolektive, që është obligim i komunës. Me të drejtë e ngritni çështjen e kanalizimit, ujit të pijshëm, çështjen e mirëmbajtjes së rrugëve dimërore dhe verore, edhe këto janë dy nivele, edhe niveli qendror duhet të mirëmbajë rrugët e nivelit qendror, si rrugën për Gerlicë, Letnicë etj. etj. Mirëpo kur po na bllokohen mjetet, nuk po ka

paga për punëtorë që po kujdesen për pastritë, as për bursat e studentëve, sepse po bllokohet i gjithë sistemi buxhetor, sepse është bllokuar pa të drejtë dhe pa fajin e komunës sonë.

Unë gjatë zgjedhjeve nuk kam dashur që të zhvillohen konkurse, qëndrimi im dhe vendimi im ka qenë i tillë për shkak se ka pasur tendencë të konkurseve që me u keqpërdor, prandaj unë së paku e kam pasur këtë vlerësim dhe ndoshta kam punuar kundër vetvetes, sepse kam qenë kandidat së bashku me kolegë të tjerë. Unë kam menduar dhe kam vlerësuar në atë moment, mu ka dokë e tillë, nuk kam dashur që gjatë asaj periudhe me u zhvillu diçka e tillë e cila i jep kahe tjetër, që mu nuk ma ka marrë mendja që është e mirë në këtë rast. Do të punohet në eliminimin e problemeve me ujë, me kanalizim. Jemi tu punu në 18 fshatra për ujë, kemi nevojë për më shumë se këto fshatra. Konkretisht për ujë ka filluar projekti "FLOS" i Bankës Botërore për rritjen e kapacitetit të ujit në Letnicë, do të thotë është projekt që ne nuk e kemi thënë veç, po ai është realitet. U zgjodh fituesi, kanë filluar punimet, i kemi disa vështirësi rreth një prone të cilën e kemi tejkaluar dje me një takim bashkë me donatorin e Bankës Botërore dhe me Hidro Moravën, nivelin qendror juridikisht. Kemi me kalu me çu një parcelë në shpronësim, do ta sjellim në kuvend shpronësimin e asaj prone. Te nxemja në shkollën e mesme aty ka qenë një investim i Bashkimit Evropian, kemi pasur problem me rrymën. Rrymën ata nuk e kanë investuar, ne u dashtë me qit thirrje me KEDS-in, kemi bashkëpunuar dhe e kemi zgjedhur këtë problem. Nuk ka qenë e lehtë me pru trafo të re për shkak se procedurat kanë qenë burokratike dhe janë vonuar, po insistimi ka qenë i madh dhe janë rregulluar këto çështje. Jemi munduar me bë revitalizime të lumenjve, të përrenjve dhe jemi tu punu ende. I kemi bërë 5 gropa septike në vitin 2025. Në ekoturizëm jemi munduar, i kemi përkrahur fermerët, të gjithë sektorët. Jemi munduar vërtet edhe me transparencë, kemi bërë debate, ju kemi ndihmuar klubeve sportive me i përkrahur, kemi me nejtë në kontakt siç kemi nejtë me klubet sportive, bujqit, artistët.

z.Ekrem Abazi: Gjatë informatës që e tha kryetari e pyta nja dy-tri herë veten: a thua a jam kanë tu jetu në Viti unë a po nuk jam kanë tu jetu këtu? Pasi unë hiç nuk ma rroke logjika ime çka ka ndodhë e çka u deshtë me ba e çka, pas ba ma e keqja, nuk i ka bë ato punë hiç te uji i pijes, që 12 vite, ke fillu mandatin e katërt, gjithëmonë ki pas diskutime që gypat janë kancerogjen, gjithëmonë ki thanë "do t'i heqim", tash mandati i katërt e nuk ki bë kurgja. Këta gypa që janë kancerogjen, që sot pinë qytetarët e Vitisë ujë aty. Sa i përket asaj që e the në 18 fshatra kemi me e shti rrjetin, rrjetin e keni shti moti, po ujë nuk kanë. Unë po ju thamë, te lagjja ime, shumica e dini ku e kam shpinë, jemi 16 familje, 14 pompa i kemi se nuk shkon në katin e parë uji aty ku unë jetoj, e leje më tjetërkund. Konkursët i ke ba 100% për qëllime politike, se ti llogaritë din me i ba shumë mirë. Ti, për sa vende të punës kanë konkuru 10-fishi më shumë se që u deshtë mu pranu atëherë. Ti, nëse e kishe marrë dikë, e kishe marrë të klaneve tua, vetëm klaneve tua, jo të partisë që i ki atëherë. I kishe rahat 10 ose 15 vetë, i kishe idhëru 100 ose 200 familje që kanë konkuru. Sa i përket zgjedhjeve që i ki fitu, edhe vet nuk ke mendu që i fiton, po qysh i ke fitu e din ti më së miri, e dimë edhe na, po më së miri e din ti. I ke fitu me joshje, i ke fitu me rrena, me mashtrime, edhe në fund të ka votu qytetari. E tash po shihet: ke marrë punëtorë me kontrata e pa kontrata, nuk ki pas karrige se ku me i ul punëtorët, kanë nejtë edhe naper kafe gjatë zgjedhjeve. Sa i përket punës, tanë ky raport ka qenë dashur me u dhënë në vitin 2025, jo këtë vit, sepse shumica e këshilltarëve janë të rinj. Kisha propozu këtij kuvendit që kryetarit tonë, që e ka fitu mandatin e katërt, t'i ndërtohet një përmendore te sheshi, se me të vërtetë e meriton.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës: Fjalori i juaj është i rëndë dhe ofendues. Zgjedhjet i kam fitu edhe, mos me m'shtin me thanë, i fitoj apet, se qytetarët ma japin votën për shkak të punës së mirë. Konkursët, nëse unë i kam bë ashtu, Sadrin tanë nuk e kam marrë ashtu, ai e ka fitu me meritë vendin e punës, e shumë të tjerë. Sa i përket asaj të konkurseve, edhe në debate e kam mbrojtë: jam për punësim të gjeneratave të reja, jam për punësim të qytetarëve të papunë të Vitisë, vetëm me formë ligjore. Edhe sot po ju thamë: jam për punësim të gjeneratave të reja të kualifikuara. Qysh i gjejmë formën e financat është punë e jona. A ju që jeni mos me i punësu e jeni vetëm për anëtarët e familjes me i punësu, është çështje tjetër. Unë kam me shku deri në transparencë të plotë. Ata që i kanë fitu zgjedhjet me joshje, me imponime, dallavere, me premtime boshe, me bllokota shtetërore institucionale, ata dije kanë adresë. E ata që kanë punu nuk e kanë rreziku funksionimin vital të shtetit, e kanë implementu buxhetin 99.7, kanë punu nga 7 ditë në javë, edhe ata që kanë punu me partnerë, ata e dinë kush janë. Ke fol edhe për gypat kancerogjen dhe për 18 fshatrat për rrjet. Unë thashë 5 fshatra plus

7 janë kanë më herët, rrjeti i shtim, po 18 është përmbyllje e projekteve, të cilat një pjesë janë të reja, 4 që i numërova, një pjesë janë të përfunduara. Gypat kancerogjen: ne kemi investu në 13 kilometra gyp të asbestit prej Letnice deri në Viti, ne e kemi ndërru dhe e ka financu, e bashkë me komunë e kemi financu. Pjesa tjetër masanej e ka investu SDC-ja zvicerane. Kemi ndërru në lagje të tëra, tu e përfshi edhe gypin e asbestit në shumë lagje, edhe aty te shtëpitë e këshilltarit. E këto që nuk janë ndërru, edhe unë po thamë që duhet mu ndërru, duhet me planifiku me buxhet, me bë planin së bashku.

z.Labinot Bislimi: Përsëritetja të nderur të pranishëm, unë e ndëgjova kryetarin dhe është e vërtetë se nuk i kemi 100 metra në sekondë ujë, po i kemi 100 fjalë në sekondë të kryetarit. Kjo është e sigurt dhe në të gjitha ato fjalë që i tha është një përzierje temash e pa fund për me e mbulu të vërtetën e madhe, që kryetari po flet si të ishte në mandatin e dytë, po në fakt është mandati i katërt. Duke qenë në mandatin e katërt, kur flet për Vitisë, mjedisin, shkollën, rrugën, lumenjtë etj., thua ti ku ka qenë për katër mandate, dmth mandati i katërt, dhe që nuk i paska zgjidh këto çështje, bile as nuk janë nis. Foli për mjedisin: Vitia është vendi me më së shumti mbeturina ndoshta në Kosovë, se për Evropë është e sigurt. Foli për lumenjtë, për vërshimet, po ku jemi ne, ku jetojmë? A nuk ka pas vërshime këto ditët e fundit, para disa javëve, para disa muajve, vitin e kaluar, mandatet e tjera? Të gjithë jemi këtu. Qysh me të thanë që nuk je tu rrejtë, se fjalë tjetër nuk kemi. Këto janë rrena të kulluara dhe të gjitha raportet që bëhen janë të pasakta, të pavërteta, për me e mbulu të vërtetën e madhe. Vitia është me mbeturina, a ka ujë, nuk ka, dmth është rrenë. Qysh me thanë ndryshe kur që tri mandate thotë që ka ujë në Skifter, në Verbanë, e nuk ka. Mjedisi, mbrojtja e mjedisit, për cilën mbrojtje po flet, kur ka mbeturina gjithkrah nëpër Viti? Qysh me i thanë ndryshe? Po doni me na i zgjedh edhe fjalët qysh me i thanë? A t'i mos rrej? Unë nuk po të thom rrenacak, a ke në RTK tha nuk ka pas vërshime në Viti? Sa i përket zgjedhjeve, të gjithë në Viti, përfshi kryetarin, kryesuesin, asambleistët, qytetarët, e dinë se ka pas blerje të votave. Të gjithë, vetëm prokurori nuk e di. Dhe unë prej kësaj salle po i bëj prapë thirrje prokurorit që të merr hetim, sepse kurrë nuk ka pas blerje të votave më shumë se kësaj here në Viti. Unë nuk e kuptoj pse nuk ka hetime në këtë drejtim. Kryetari e tha që jemi tu i bë edhe dy drejtori për interesa të qytetarëve. Të gjithë e dinë që këto dy drejtori në fakt janë vetëm për interesat e klaneve politike, të cilat kanë lidhë marrëveshje dhe të gjitha këto marrëveshje kanë rrjedhë në mënyrë tinëzare deri këtu, jo transparente, dhe sot realisht qytetarët nuk e dinë saktë për çka është fjala për ato marrëveshje dhe për çka është ka kërkohe. Kryetari tha: na jemi për me punësu. Me fal, a je patron i naj kompanie, a je tu udhëheqë industri? Se unë sot po ndëgjoj se komuna e paska mundësinë për me punësu, qëllimi i saj të koka për me punësu sa më shumë njerëz, mos me lanë me ikë. Komuna në një shtet demokratik dhe në një shtet kapitalist bën, jep konfiguracione, bën investime që sektori privat me punësu. E ky vetë e pranon që në këtë komunë ka klientelizëm të skajshëm dhe ku qëllimi është me punësu sa më shumë njerëz, jo për qëllim mos me ikë, po për me kriju klientelë për vota të ardhshme. Edhe këto dy drejtori bëhen mend për katër mandate. Asnjë zgjidhje nuk është ofru, e vetmja për të gjitha ato që u folën. Gjithçka është pikënisje: e kam nis këtë, atë, e përfundim nuk ka. A keni ndëgju naj projekt që u përfundu në 2025, as më herët? Për gjatë gjithë këtyre mandateve gjithçka është tu fillu. Uji, kanalizimi, shtrohet pyetja: kur edhe sa mandate të duhet? Po sot qytetarët e dinë kush është Sokol Haliti. Nuk është kjo kurgja personale dhe s'jam tu iu drejtu kërkujt personalisht, po jam tu iu drejtu si kryetar e politikan. Po kjo marrëveshje e koalicionit që vjen me dy drejtori të reja, qëllimin përfundimtar e kanë për me i shërby njëri-tjetrit e jo interesave të qytetarëve.

z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës: Lab, ti e ki pas babën nënkryetar të komunës, e çka paska bë ai? E ti, mu rritë në Francë, me përdor kësi fjalori nuk e di. Gjithmonë për ambient e mjedis duhet me fol, edhe në strategjinë botërore në të cilën Vitia është komuna e tretë në strategjinë e Evropës Juglindore që ka hi, e ku bën pjesë edhe mjedisi e ambienti, bujqësia, efikasiteti në energji, biomasa, biogazi etj., janë gjithmonë prioritet i komunës së Vitisë. Unë tri-katër vitet e fundit kam bë vendime në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e ambientit dhe mbrojtjen e pyjeve. E tash lumenjtë, ndoshta komuna e parë në Kosovë kemi fillu me i revitalizu: në Viti lumin Morava, lumin Letnica, Rekën e Buzuvikit e kanale të tjera. A është mjaftueshëm? Nuk është. Këto kanë qenë të mbyllura të gjitha dhe kompetenca për lumenjtë sa i përket komunës, po adresimi është i gabueshëm. Vërshimet e dimë çfarë kanë qenë, kanë shkaktë dëmtime, po me së paku në nivel vendi. Kërkush në Kosovë dhe në Evropë më pastër se Sokol Haliti me ekipin e vet, sa i përket votës dhe verdiktit të lirë të

qytetarëve, nuk ka punu dhe nuk punon. Mbye mend këtë fjali, por nuk jam tu i akuzu as partnerët për nivel qendror, e kam mendimin tjetër. Zgjedhjet më normale, më demokratike, pa ndërhyrje, me respekt të njëri-tjetrit, pa asnjë fjalë. Nuk mundesh me ma gjetë që e kam ofendu dikë; muj mos me u pajtu, ama nuk përdori fjalor fyes. Projektet e papërfunduara në 2025 ti po m'i thotë, e unë po të thamë që Vitia është më ambientale se krejt komunat, më infrastrukturore. Thave projektet e papërfunduara, po projektet e përfunduara: projekti i Mjakit është i përfunduar 2025, projekti i Vernakollës është i përfunduar, fushat e futbollit me goma në disa fshatra, punimet e ujësjellësit në katër fshatra, punimet në fshatin e ri, hapja e çerdhes në Droresh, e punë të tjera që janë kry për vitin 2025.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Falemenderit të gjithëve për kontributin e dhënë.

Pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi ka obligim t'i themelon dy komitete obligative: Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete. Dhe në bazë të statutit i kemi të paraparë edhe disa komitete që mund të themelohen, komitete jo obligative. Kërkoj nga grupet parlamentare, që t'i propozoj emrat për anëtarë të komitetit. Propozim vendimin e keni marrë, e dini nga sa pozita i kemi në KPF.

z.Basri Aliu: Grupi parlamentar i LDK-së, me marrëveshje për anëtarë të KPF-së propozon Basri Aliun, Ilir Zukën dhe Zejnepe Osmanin.

z.Visar Demiri: Grupi parlamentar i PDK-së për anëtarë të KPF-së propozon Elsa Jahija.

z.Remzi Salihu: Grupi parlamentar i LVV-së për anëtarë të KPF-së propozon Jakup Demirin dhe Liridona Bislimin.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Janë 7 anëtarë që propozohen në KPF: a jeni që të miratohen këta emra. Me 22 vota pro, 1 kundër, 0 abstencion miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete

Edhe ky komitet do të jet me 7 anëtarë, mirëpo sipas ligjit, më shumë se gjysma duhet të jet nga komitetet jo shumicë. Nga komitetet propozimet kanë ardh këtu. Një anëtar i takon PDK-së, një LDK-së dhe NISMA-s e cila është pjesë e marrëveshjes. Ju lutem propozimet.

z.Remzi Salihu: Sa i përket këtij komiteti, ne mendojmë se neve si LVV na takon një anëtar në këtë komitet si grup i tretë që jemi në kuvend. Nëse ka ndonjë nen që e përcakton ndryshe, ne do ta përkrahim, se përndryshe kjo na takon neve si grup.

z.Basri Aliu: Grupi parlamentar i LDK-së, me marrëveshje për anëtar të Komitetit për Komunitete e propozojmë Djellza Fejzullahun.

znj.Elsa Jahija: Grupi parlamentar i PDK-së për anëtar të Komitetit për Komunitete, propozon Visar Demirin.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Nga NISMA është një anëtar, Elham Emërllahu. A jeni që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës: kush është? Për 17, kundër nuk ka, abstencion nuk ka, me 17 vota miratohet.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e iniciativës së Kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Edhe mandatin e kaluar e kemi pas iniciativën, e kemi kalu, ka punu grupu punues, ka qenë në konsultim publik, mirëpo nuk i kemi pas votat, i kemi tërjek këtë propozim. Tash u

ndërru legjislatura e kuvendit, e duhet me fillu me inicim, tu e pas parasysh se prej vitit 2011 ka pas ndryshime të ligjeve, e ku në pjesë të statutit është ndryshu, e duke përfshi edhe kërkesën e ndërrimit të drejtorive duhet të fillojmë me ndryshim plotësim të statutit. A ka diskutime rreth kësaj pike?

z.Ekrem Abazi: Po me vjen mirë që, pas 1 muaji ju paska ra në mend që duhet me bë propozim vendim për ndërrimin e statutit me i shti dy drejtori të reja.

z.Illir Zuka: Kryesues, për shkak se është koha e drekes, në emër të grupit po kërkoj që të shkojmë në drekë edhe e vazhdojmë pas drekës.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Shkojmë në pauzë. Në ora 1:30 kthehmi i vazhdojmë punimet.

Pas pauzës: Fillojmë me pjesën e dytë të seancës. Vazhdojmë aty ky mbetem: a ka dikush me diskutu tek pika e inicimit për ndryshim plotësim të statutit. Pasi që nuk ka diskutim e qes në votim për miratim. Me 22 vota pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me 22 vota miratohet kjo pikë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Nga ekzekutivi janë të propozuar, e keni me propozim vendim. Nga shoqëria civile e propozojmë Albulena Selmani, edhe nga tri parti politike ka një propozim. Nga LDK-ja kush propozohet? Yllka Qamili. Nga PDK-ja? Ardita Hajdari. Dhe LVV? Majlinda Shabani. A jeni që të miratohet kjo pikë e rendit? Me votat e të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunës së Saint Julien en Genevois

z. Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Para vete e keni propozimin për nismë dhe autorizimi. Kemi qenë një delegacion i joni atje, edhe ata kanë qenë këtu e kanë përgatit draftë marrëveshjen e bazuar në Ligjet e Republikës së Kosovës. Duhet të miratohen këto në Kuvend, dhe kërkoj miratimin e këtyre pikave që janë, nën a dhe b.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Hapi diskutim për këtë pikë.

z.Remzi Salihu: Kisha pas një kërkesë të na shpjegohet se çka fiton Komuna e Vitisë, njëkohësisht qytetarët e Komunës së Vitisë nga kjo marrëveshje. Ne jemi pro.

z.Basri Aliu: Realisht kjo ka qenë iniciativë e cila ka rrjedh nga viti 2017, ndërvite është forcu, e ka ardh deri te kjo pikë që të arrim në marrëveshje, se normal që edhe Komuna e Vitisë përfiton nga kjo marrëveshje.

z.Visar Demiri: Është mirë që Komuna e Vitisë të ketë marrëdhënie me komunat jashtë Kosovës, jo vetëm me këtë komunë po edhe me komunat tjera, me të cilat kishim mujt me nda bashkëpunim kulturor, po edhe ekonomik, prandaj jemi pro kësaj.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Me të drejtë këshilltari pyet, cilat janë përfitimet në marrëveshje që kemi bisedu. Janë nja 5-6 pika që parashihen në fushat e bashkëpunimit. Një ndër to është edhe ajo që thashë, e rinisë, sportit, po ka edhe në aspektin ekonomik.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës, nën a. Kush është për? Me votat e të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Tani qes në votim për miratim këtë pikë nën b. Me votat e të gjithëve miratohet edhe kjo pika b.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

- 8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Komunën e Vitisë**

